

SHENIMET SHPJEGUESE

**1) TE DHENA TE PERGJITHSHME TE SHOQERISE**

Shoqëria : "UJESJELLES MAT" SH.A. Burrel, është krijuar me date,28/09/2000 me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Nr. 24435 me te cilin Shoqëria është rregjistruar në Rregjistrin Tregtar. Krijimi i kesaj shoqerie është bazuar ne ligjin Nr.7638 Dt.19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare", Shoqeria ne baze te ketij ligji Seksioni III, Neni 94, 95 është shndërruar dhe funksionon si Shoqeri Anonime.

Selia e shoqerise është ne adresen: **lagja Partizani,Rruga Ibrahim Temo Burrel.**

Ajo është regjistruar prane organeve tatimore te rrethit Tirane me **NIPT J68103917F**

**Objekti i veprimtarise se Shoqerise "UJESJELLES MAT " SH.A. Burrel,është:**

*"Sherbimi I furnizimit me uje te pijshem I konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit(ve) te furnizimit te ujit te pijshem. Prodhimi dhe blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi I grumbullimit, largimit dhe trajnimit te ujerave te ndotura dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe te impanteve te pastrimit te tyre".*

*Shoqeria ka status: **AKTIV***

Veprimtaria e Shoqerise zhvillohet ne nje afat kohor te pa caktuar.

*Shoqeria per gjithe keto vite, ka per objekt te veprimtarise ate qe ka te regjistruar ne **QKB.***

**a) Kapitali dhe pronësia**

Sipas informacionit te mare ne QKB, Kapitali i Shoqerise ne momentin e krijimit te saj është 175 269 000 leke. Gjate gjithe periudhes qe nga krijimi i shoqerise se deri ne 31.12.2018 kapitali i shoqerise ka pesuar disa here ndryshime dhe se fundmi, me Vendimin nr.7,date 04/12/2017, kapitali është zamdhuar ne vleren prej 729.777.000 leke.

Sipas ketij Urdheri numri i aksioneve është bere "1" dhe vlera nominale per nje aksion është leke, Ndersa ne QKB, numri kontributeve ne aksione është dhe Vlera nominale e aksionit 729.777.000 leke. Aksioner i vetem i Shoqerise është Bashkia Mat, Perqindja e pjesmarjes 100%.

**b) Administrimi**

1-Struktura organike, Administrimi, Organizimi dhe Drejtimi i pershtaten natyres se Shoqerise dhe realizimit te objektit të veprimtarisë së saj. Administrimi është me system me nje nivel. Administrator i Shoqerise,sipas Ekstratit te Regjistrin Tregtar te QKB-se, është z. Arjan Lika i cili është emeruar me 21/03/2016 deri me 15/04/2022. Administrimi i kesaj Shoqerie behet nga Administratori, dhe Keshilli i Administrimit,i cili është organi vendimmarres per administrimin.Vendimet kryesore,sipas Ligjit tregtar dhe sipas statutit siç jane: Emerimi i A Administratori dhe Keshillti te Administrimit,Emerimi i Eksperteve Ligjor,Miratimi i Pasqyrave Financiare,Zmadhimi apo Zvoglimi i Kapitalit..etj meren nga Asamblea,ku kjo Asamble është Kryetari i Bashkise Mat.

Anetaret e keshillit administrues ne dt.31.12.2018 jane:

- Shaban Lleshi
- Arjan Lika
- Pajtim Molla

2-Organika e te punesuarve e Shoqërise "UJESJELLES MAT" SH.A është si me poshte vijon:

NR	EMERTIMI SIPAS FUNKSIONIT	NR. I PUNONJESVE
1	ADMINISTRATOR	1
2	DREJTORIA TEKNIKE	

	DR. TEKNIK	1
	Specialist ne aparat	4
	Sektori I Mirmbatjes qytet	17
	Sektori I Mirmbatjes fshat	23
	Sektori Operativ I rrjetit	7
	<b>Shuma Dr.Teknike</b>	<b>52</b>
<b>3</b>	<b>Drejtoria Tregtare</b>	
	DR. TREGTAR	1
	Sektori I Finances	3
	Sektori I arketimeve dhe faturimeve	9
	<b>Shuma Dr. Tregtare</b>	<b>13</b>
<b>4</b>	Sektori I burimeve Njerezore	6
	<b>TOTALI</b>	<b>72</b>

Ndryshimet ne Administrimin e Shoqerise jane pasqyruar ne Qendren Kombetare te Biznesit .

## 2) Mbi Kontabilitetin

Baza e pergatitjes te Pasqyrave Financiare.

1. Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
2. Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2;)
3. Baza e pergatitjes se PF : Mbi bazen e konceptit te materialitetit.(SSK 1, 1-3)
4. Parimet baze per pergatitjen e Pasqyrave Financiare: (SKK 1; 40 - 90)
  1. Parimi i njesise ekonomike: mban ne llogarite e saj aktivet,detyrimet dhe transaksionet ekonomike te veta.
  2. Parimi i vijimesise: vepriktaria ekonomike e njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.
  3. Kompensimi: midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
  4. Kuptushmeria e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
  5. Materialiteti eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
  6. Besushmeria per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
    - Parimin e paraqitjes me besnikeri
    - Parimin e perparesise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
    - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
    - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
    - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
    - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
    - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

## 3) Politikat kontabel

Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" ( hyrje e pare,dalje e pare.(SKK4: )

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; )

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivitetit per periudhen e investimit.(SKK 5: ) Per

vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5; )

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5:) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te A.Agj.M metoden e amortizimit mbi bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 1 % te vleres fillestare.
- Per linja e ujesjellsave 5% te vleres se mbetur.
- Mjete transporti 15% te vleres se mbetur.
- Pajisje informatike 25% te vleres se mbetur.
- Paisje orendi, Instalime teknike, makineri, pajisje,instrumente,vegla pune 25% te vleres se mbetur.
- Programe kompiuterike 25% te vleres se mbetur.

Kontabiliteti mbahet ne menyre te kombinuar, manuale dhe me ditare e centralizatore te hartuar ne tabela exceli.

#### SHPJEGIME DHE SUGJERIME PER PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN 2018

##### 4) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne arke perputhen me ineqntarin fizik gjendje me date 31.12.2018. Mjetet monetare ne banke perputhen me nxjerrjet e llogarive te bankave ne date 31.12.2018. Analitikisht mjetet monetare te shoqerise te shprehura ne leke paraqiten si me poshte:

Aktive Monetare	31.12.2018	31.12.2017	Ndryshimi +/-
Para ne Banka	4.612.654	2.932.929	1.679.725)
Vlera arke	0	0	(0)
<b>Totali</b>	<b>4.612.654</b>	<b>2.932.929</b>	<b>(3,264,734.09)</b>

##### 5) Aktive afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra mbahen, rregjistrohen dhe administrohen nga shoqeria ne zbatim te normave dhe parimeve te kontabilitetit dhe ekzistojne realisht ne pronesi te shoqerise. Ato paraqiten si me poshte vijon:

Aktive te tjera Afatshkurtra	31.12.2018	31.12.2017	Ndryshimi +/-
Kliente per mallra produkte e sherbime	34.319.812	31.369.919	2.949.893
Kliente te tjere	6.346.272	6.346.272	0.00
Debitore dhe kreditore te tjere	2.607.969	2.607.969	0.00
<b>Totali</b>	<b>43.274.053</b>	<b>40.324.160</b>	<b>2.949.893</b>

**Pasqyrat Financiare Viti 2018**

Llogaria Kliente paraqitet me nje vlere neto prej 34.319.812 leke dhe ndryshon ne raport me vitin 2017 ne vleren 2.949.893 leke.

Per llogarite "Kliente te tjere" dhe "Debitore dhe kreditore te tjere" nuk ka ndryshime me periudhen paraardhese 2017.

Per Llogarite debitore Shoqeria ka analiza te detajuara, si dhe per pjesen me te madhe te tyre njej historikun e krijimit te tyre dhe ka krijuar dosje te vecanta per nje pjese te mire te debitoreve.

**6) Inventaret**

Gjendjet inventariale ne date 31.12.2018 jane **20.307.333 leke**. Vlerat inventariale evidentohen ne kontabilitet ne date 31.12.2018 me kosto blerje.

Gjendja inventariale paraqitet si me poshte:

<b>Iventaret</b>	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Lende te para e mat. te tjera.	19.399.986	19.227.774	172.212
Inventare I imte	613.857	283.857	330.000
Lende djegese ( Nafta)	293.490	17.386	276.104
<b>Totali</b>	<b><u>20.307.333</u></b>	<b><u>19.529.017</u></b>	<b><u>778.316</u></b>

**7) Aktivet afatgjata materiale**

Aktivt aftagjata materiale paraqiten ne bilancin e shoqerise me vleren neto te tyre.

<b>Aktive Afatgjata Materiale</b>	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Toka	6.191.120	6.191.120	0
Ndetesa	8.858.807	8.979.587	-120.780
Linja ujesjellesi + Kanalizime	584.208.851	49.312.175	534.896.676
Mjete Transporti	1.218.336	1.433.337	-215.001
Pajisje Informatike	1.180.957	880.004	300.953
Instalime taknike, makineri	1.748.417	2.043.261	-294.844
Aktivt afatgjata jomateriale	594.223	792.298	-198.075
<b>Tot. AAM ne admin. te Shoqerise</b>	<b><u>604.000.711</u></b>	<b><u>69.631.782</u></b>	<b><u>534.368.929</u></b>
<b>Totali i AAM</b>			

Aktivt afatgjata materiale jane rritur me nje vlere neto prej 534.368.929 leke,ku kjo rritje ka ardhur si rezultat :

1. Marrja ne dorezim te linjave te Ujesjellsave te Njesive Administrative te cilat ishin ne administrim te Bashkise Mat shuma 612.181.287 leke.
2. Blerje e pajisjeve informatike dhe instalime te tjera ne shumen 589.300 leke.
3. Pakesime nga amortizimi vjetor ne vleren 78.401.658 leke.

**Shtesa gjithesej**

$$(612.181.287 + 589.300) - 78.401.658 = 534.368.929 \text{ leke}$$

## 8) Detyrimet afatshkurtra

Me poshte paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra ne date 31.12.2018 :

Detyrimet Afatshkurtra	31.12.2018	31.12.2017	Ndryshimi +/-
Te pagushme ndaj furnitoreve	2.423.598	494.405	1.929.193
Detyrime tatimore per tapi-in	65.026	51.506	13.520
Te pagushme ndaj punonjesve	2.259.234	0	2.259.234
Detyrimet tatimore per tatim-fitimin	0	90.000	-90.000
Detyrime tatimore per TVSH	341.256	961.345	-620.089
Detyrime tatimore per tatimin ne burim	207.050	120.559	86.491
Sigurime shoqerore & shendetsore	689.985	492.821	197.164
Debitore dhe kreditore te tjere	2.082	0	2.082
<b>Totali</b>	<b>5.988.231</b>	<b>2.210.636</b>	<b>3.777.595</b>

- Zeri "Te pagueshme ndaj furnitoreve" perfaqeson detyrimet e ndermarrjes ndaj furnitoreve per blerje e sherbime te palikujduara ne shumen 1.895.118.4 leke taksa bashkiake ne shumen 474.800 leke energji elektrike 53679.6 leke Totali ne leke 2.423.598 leke.
- Ne zerin " Detyrime tatimore per tapi-in " perben detyrimin e muajit dhjetor 2018 ne shumen 65.026 leke
- Ne zerin "Te pagueshme ndaj punonjesve", vlere prej 2.259.234 leke i perket detyrimeve per pagat e muajit dhjetor 2018.
- Ne zerin " Detyrime tatimore tatimim-fitimin" 0 leke.
- Ne zerin " Detyrime tatimore per TVSH-ne" perben detyrimin e TVSH-se per muajin dhjetor 2018.
- Ne zerin " Detyrime tatimore per tatimin ne burim" ne shumen 207.050 leke perfaqeson tatimin e Keshillit te Administrimit dhe tatimin e Shperblimit te fund-viitit dhjetor 2018.
- Ne zerin " Sigurime Shoqerore & shendetsore " ne shumen 689.985 leke perfaqeson shumen e detyrimeve per muajin dhjetor 2018.
- Ne zerin " Debitore dhe Kreditore te tjere ne shumen 2.082 eshte detyrim ndaj OSHEE per arketim te gabuar ne llogari te Ujesjellesit.

## 9) Detyrimet afatgjata

Me date 31.12.2018 shoqeria ka detyrime afatgjata si me poshte vijon:

Detyrimet Afatgjata	31.12.2018	31.12.2017	Ndryshimi +/-
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

## 10) Kapitalet e veta

Ne 31 dhjetor 2018 vlere e kapitalit aksionar te rregjistruar i shoqerise eshte 729.777.000 leke. Vlere e kapitalit zoterohet ne kuotat 100% nga Bashkia mat.

**Pasqyrat Financiare Viti 2018**

Shoqeria rezulton me Humbje te mbartura ne shumen 60.761.410 leke dhe fitim te vitit ushtrimor 2018 ne shumen 2.835.074 leke.

**11) Te ardhurat**

Te ardhurat e vitit 2018 me nje total prej **46.059.365** leke perbehen nga; te ardhura nga shitja e ujit ne vleren **42.143.328** leke, te ardhura nga buxheti i shtetit ne vleren prej **2.317.760** leke ( Grandet) si dhe te ardhura te tjera financiare ne vleren prej **1.595.081** leke dhe nga interesat bankare **3.196** leke.

**12) Shpenzimet**

Shpenzimet e vitit 2018 paraqiten me nje total prej **42.723.984** leke , ku shpenzimet per paga e sigurime kapin vleren **26.616.695** leke.

**13) Fitimi humbja neto e vitit ushtrimor.**

Gjate ketij viti ushtrimor shoqeria ka rezultuar me fitim ne vleren **2.835.074** leke.

**14) Sqarime ne lidhje me vijimesine.**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur me parimin e vijësisë. Përdorimi i këtij parimi të kontabilitetit është i përshtatshëm përveç rasteve kur drejtimi ka për qëllim të likuideojë Shoqërinë apo të ndalojë veprimtarinë e saj, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër. Përdorimi i parimit të vijësisë nga drejtimi duhet parë me analitik ne planifikimin e kostove dhe te ardhurave te priteshme . Drejtimi nuk ka identifikuar ndonjë pasiguri materiale që mund të ngrejë dyshime mbi aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijësi, dhe për rrjedhojë nuk ka përfshirë ndonjë rast të tillë në shënimet e pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare, nuk kane pasiguri materiale dhe garantohet aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijësi.

**15) Ngjarje pas dates se raportimit.**

Ne 31 dhjetor 2018 ne daten e hartimit te ketyre pasqyrave financiare, si dhe gjate periudhes qe keto pasqyra jane ne proces miratimi dhe auditimi nga Organet Kopetente, nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rendesishme per te paraqitur ne keto pasqyra.

**Pergjegjesi i Finannces**

**Liljana LLESHI**



**Administratori**

**Arjan LIKA**

